



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 215/5 prot.

Tiranë, më 09.04.2024

Lënda: Përcillet për njohje dhe zbatim Vendimi i Rektoratit Nr. 7, datë 08.04.2024

FAKULTETIT TË MJEKËSISË
Dekan Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI

FAKULTETIT TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE
Dekan Prof. Dr. Ilirjana ZEKJA

FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE
Dekan Prof. Dr. Edit XHAJANKA

SEKTORIT TË BURIMEVE NJËRËZORE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE E BURIMEVE NJËRËZORE

PROF. DR. ELIZANA PETRELA
KOORDINATORE E PROJEKTIT "IDEA"

Këtu

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese, ju përcjellim për njohje dhe zbatim Vendimin e Rektoratit Nr. 7, datë 08.04.2024 "Për miratimin e disa detyrave shtesë për personelin e zyrave të karrierës dhe marrëdhënieve me studentët në njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në kuadër të projektit IDEA".

Duke ju falënderuar,

REKTORI

ARBEN GJATA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 1046 / Prot.

Tiranë, më 08.04 /2024

3

VENDIM
Nr. 7, datë 08.04.2024

PËR
“MIRATIMIN E DISA DETYRAVE SHITESË PËR PERSONELIN E ZYRAVE TË
KARRIERËS DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË NJËSITË KRYESORE
TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË, NË KUADËR TË PROJEKTIT
IDEA”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe neni 40; në Statutin e UMT-së, neni 5 dhe neni 31; në Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 19, nenin 63, pika 4; në shkresën e Zëvendës Rektores së UMT-së me nr. 215/1 prot., datë 22.02.2024 “Kërkesë për trajtimin në mbledhjen e radhës së Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, Rektorati i UMT-së në mbledhjen e tij të datës 08.04.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Zëvendës Rektores së UMT-së me nr. 215/1 prot., datë 22.02.2024 “Kërkesë për trajtimin në mbledhjen e radhës së Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.
2. Personeli i Zyrave të Karrierës dhe Marrëdhënieve me Studentët në njësitë kryesore të UMT, në kuadër/vazhdimësi të projektit “IDEA” të kryejë edhe detyrat shtesë, si më poshtë:
 - a. Të informojë dhe udhëzojë studentët me aftësi ndryshe mbi kërkesat, aksesin, bursat e disponueshme dhe teknologjitë ndihmëse, që UMT ka në dispozicion, për studentët me aftësi ndryshe;
 - b. Të lehtësojë mbështetjen ndaj personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ për studentët me aftësi ndryshe;
 - c. Të sigurojë të dhëna, raporte dhe rekomandime për të realizuar objektivat e përfshirjes institucionale;
 - d. Të mbështesë projekte dhe aktivitete dhe veprimtari të fokusuar në gjithëpërfshirje.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, njësitë kryesore të UMT-së, Personeli i Zyrave të Karrierës dhe Marrëdhënieve me Studentët në njësitë kryesore të UMT, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT si dhe strukturat e burimeve njerëzore në njësitë kryesore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
ARBËN GJATA



TIRANË